Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

21/2023

KUSHTETUTSHMËRIA NË QEVERISJE

Dhjetor 2023

Autor: Naim Jakaj

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Gzim Shala.

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe të National Endowment for Democracy (NED).

Implementuar nga:

Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Mbështetur nga:

NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
Email: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Dhjetor, 2023
Prishtinë, Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT

9 1. Përmbledhje ekzekutive

10 2. Rëndësia e Gjykatës Kushtetuese në sistemet demokratike

10 3. Ligjet dhe vendimet e miratuara nga viti 2008 dhe dërgimi i tyre në Gjykatë Kushtetuese sipas secilës legjislaturë

15 4. Shkeljet kushtetuese në shkarkime

15 4.1 Shkarkimi i pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

16 5. Cenimi i pavarësisë së organeve të themeluara me kushtetutë

16 5.1 Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës

16 5.2 Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

17 5.3 Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së pajustifikueshme

18 6. Cenimi i pavarësisë së organeve të themeluara me ligj

18 6.1 Cenimi i pavarësisë së transmetuesit publik

19 6.2 Cenimi i të drejtave të njeriut

19 7. Cenimi i përgjegjësive komunale

19 7.1 Cenimi i përgjegjësive komunale në arsim

21 7.2 Cenimi i të drejtës në shpenzim të të hyrave vetanake komunale nga vitet paraprake

21 8. Mos-ushtrimi i kompetencës kushtetuese të Avokatit të Popullit dhe deputetëve të Kuvendit

22 9. Ligjet e tjera në procedurë të vlerësimit nga Gjykata Kushtetuese

22 9.1. Kontestimi i Ligjit të Pagave në Sektorin Publik

23 9.2 Pretendimet për ndërhyrje arbitrare në parimet dhe vlerat e ekonomisë së lirë

23 9.3 Pretendimet për cenim të përgjegjësive komunale në vjeljen e të hyrave vetanake

24 9.4 Pretendimet për shkelje të vlerave, barazisë para ligjit, mbrojtjes së pronës, të drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit dhe mbrojtjes shëndetësore dhe sociale

25 9.5 Pretendimet për shkelje kushtetuese në shkarkimin e anëtares së Bordit të OShP-së

25 9.6 Pretendimet për shkelje kushtetuese tek Projektligji për Investime të Qëndrueshme

26 10. Zbatimi i kërkesave të Gjykatës Kushtetuese nga institucionet publike

26 10.1 Shkelja e të drejtave të pensionistëve nga vonesat në miratimin e ligjit për skemat pensionale

26 10.2 Shkeljet teknike gjatë zbatimit të Aktgjykimit për Ligjin për Zyrtarët Publik

27 11. Dëmi financiar i shkaktuar nga vendimet jokushtetuese

SHKURTESAT

RK	Republika e Kosovës
Kushtetuta	Kushtetuta e Republikës së Kosovës
KEDNj	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
GjEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
GjK	Gjykata Kushtetuese
KRK	Kuvendi i Republikës së Kosovës
QK	Qeveria e Republikës së Kosovës
GjS	Gjykata Supreme
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
ANJF	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
KK	Kryesia e Kuvendit
KPMShCK	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës
LV	Lëvizja VETËVENDOSJE!
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

1. Përmbledhje ekzekutive

Për 14 vite prej që është themeluar Gjykata Kushtetuese (GjK), ajo në 110 raste ka bërë kontrollin e kushtetuetshmërisë së amendamenteve të propozuara, ligjeve, vendimeve të Kuvendit të Kosovës, vendimeve të tjera të Qeverisë dhe akteve të tjera të miratuara nga Presidenti i Kosovës. Obligimin kushtetues për referim të amendamenteve kushtetuese e ka shfrytëzuar Kryetari i Kuvendit, derisa të drejtën inicimit të rasteve në Gjykatë si palë të autorizuara sipas Kushtetutës e kanë shfrytëzuar deputetët, Presidenti, Qeveria, Avokati i Popullit, Gjykatat dhe Komunat.

Legjislatura e VIII-të e Kuvendit të Kosovës shënon periudhën në të cilën më së shumti është debatuar në publik mbi rolin e GjK për vendimet e nxjerra nga ajo. Opozita kritikoj vazhdimisht Qeverinë për shkelje kushtetuese gjatë miratimit të politikave dhe ligjeve derisa Qeveria ka akuzuar opozitën për pengim në zbatimin e programit të saj përmes dërgimit të ligjeve në GjK, përfshirë deklaratat politike të qeverisë ndaj vet GjK, duke kontestuar në publik integritetin e gjykatës në vendimmarrje.

Kontrollin kushtetues që GjK u'a ka bërë akteve të iniciuara për vlerësim kushtetues ka rezultuar me shkelje kushtetuese të Qeverisë dhe të Kuvendit në disa raste. Sipas GjK-së, ligje të caktuara të propozuara nga qeveria dhe të miratuara nga Kuvendit nuk kanë qenë në përputhje me formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, nuk janë në përputhje me vlerat, barazinë para ligjit, me të drejtën për mjete juridike dhe mbrojtjen gjyqësore dhe se vendime të caktuara të Kuvendit kanë tejkaluar kompetencën e tij sa i përket mbikëqyrjes parlamentare.

Kështu, Gjykata gjeti se reforma në Këshillin Prokurorial të Kosovës nuk u bë në përputhje me Kushtetutën. Ajo rrëzoi në tërësi Ligjin për Këshillin Prokurorial. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese anuloi edhe Ligjin për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, Ligjin nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik dhe Ligjin Nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg.

Gjykata Kushtetutese po ashtu gjeti se shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës dhe anëtarëve të Bordit të RTK-së përbënte shkelje kushtetuese. Në një rast tjetër, Gjykata Kushtetuese gjeti se një vendim dhe një udhëzim administrativ i nxjerrë nga MAShT cenonte kompetencat e komunave.

Janë gjithsej 28 raste kur Gjykata Kushtetuese gjeti se Projektligjet, vendimet e Kuvendit, vendimet dhe aktet nënligjore të Qeverisë ishin në kundërshtim me Kushtetutën. Dhjetë (10) raste apo 36% e këtyre rasteve i përkasin Qeverisë, përkatësisht Legjislaturës aktuale (L-VIII-të). Me gjashtë (6) raste apo 21% e këtyre rasteve i takojnë Legjislaturës së VI-të. Me katër raste Legjislatura e IV-të dhe e VII-të, me dy raste Legjislatura e III-të dhe e V-të.

2. Rëndësia e Gjykatës Kushtetuese në sistemet demokratike

Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese garantojnë shkallë të lartë të pavarësisë dhe autonomisë institucionale të Gjykatës Kushtetuese (më tutje: GjK) gjatë ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësive. Që nga themelimi dhe funksionalizimi i GjK-së në tetor të vitit 2009, ajo ka ndërtuar praktikën e përcaktimit të shëmbujve që duhet të ndiqet nga institucionet e tjera, me theks të veçantë në krijimin dhe ndërtimin e një tradite të re të kushtetutshmërisë në Kosovë.

Gjykata Kushtetuese gjatë 14 viteve të funksionimit të saj përmes praktikës gjyqësore ka ndërtuar standarde të larta të të drejtave të njeriut dhe promovimit dhe respektimit të lirive themelore në rastet kur të njejtat janë shkelur nga ana e institucioneve publike.

Kushtetuta e Kosovës, përveç parimeve themelore të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, ka përcaktuar edhe të drejtën e palëve dhe cilat janë ato palë të autorizuara për të ngritur çështje para saj. Përmes Kushtetutës dhe Ligjit për Gjykatën Kushtetuese janë përcaktuar numriminimal dhe kush është palë e autorizuar para GjK-së. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë palët e para të autorizuara që mund të ngrejnë një çështje kushtetuese dhe cilat çështje mund t'i ngrejnë para GjK-së. Në anën tjetër, edhe Komunat e Kosovës kanë të drejtën e paraqitjes së rasteve që kanë të bëjnë me kontestimin e kushtetutshmërisë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.

3. Ligjet dhe vendimet e miratuara nga viti 2008 dhe dërgimi i tyre në Gjykatë Kushtetuese sipas secilës legjislaturë

Që nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës e deri me 29 nëntor të vitit 2023, Kuvendi ka miratuar 867 ligje, të cilat përfshijnë edhe ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të caktuara.

Sipas të dhënave publike në faqen e Gjykatës Kushtetuese dhe nga përgjigja e kësaj Gjykate për Institutin e Kosovës për Drejtësi (më tutje: IKD) rezulton se e drejta e ushtrimit të autorizimeve si palë në Gjykatën Kushtetuese sipas Nenit 113 të Kushtetutës (me përjashtim të paragrafit 7) është përdorur 110 herë, duke përfshirë kërkesën për vlerësim të kushtetuetshmërisë së ligjeve të caktuara, vendimeve të tjera të Kuvendit të Kosovës dhe vendimeve, veprimeve të Presidentit të Kosovës, sqarim i kompetencave të Kryetarit të Komunës. sqarim për ushtrimin e funksioneve të dyfishta, kërkesa për vlerësim të konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në legjislaturën e III-të e cila zgjati dy vite (2008-2010, koalicioni qeverisës LDK -PDK) u miratuan 205 ligje[1], dy ligje u dërguan në GjK nga Avokati i Popullit brenda afatit prej gjashtë muajsh nga dita e miratimit të ligjeve, ndërsa dy ligje të tjera u dërguan nga

[1] *Lista e ligjeve dhe projektligjeve ne procedurë*, 2001-2023, Kuvendi i Kosovës. (Shih këtë link: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ko_29_11_shq.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

Gjykata Supreme e Kosovës dhe një nga Gjykata Themelore në Gjakovë në kërkesat e tyre për kontroll incidental[2] të kushtetutshmërisë të tre ligjeve. GjK rrëzoi pjesërisht disa nene të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e deputetit, tek përfitimet pensionale të tyre, rrëzoi një paragraf të Nenit 14 të Ligjit për Kryqin e Kuq, në një rast tjetër ajo konstatoi se neni i kontestuar është në përputhshmëri me Kushtetutën. Në dy kërkesa të tjera për kontestueshmerinë e ligjeve GjK mori Aktvendim për Papranueshmëri ndërsa një rast tjetër ajo hoqi nga lista kërkesën e më shumë se dhjetë deputetëve.

Në këtë legjislaturë, GjK nxorri atkgjykim përmes së cilit ajo konstatoi shkelje serioze të Kushtetutës së Kosovës nga Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, duke mbajtur njëkohësisht postin e Presidentit dhe Kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (më tutje: LDK-së). Kërkesa ishte dorëzuar në GjK nga më shumë se tridhjetë e dy (32) deputetë të Kuvendit.

Legjislatura e IV-të zgjati tre vite (2011-2014, koalicioni PDK, AKR, SLS, GP "6+" dhe Lista "Dr. Ibrahim Rugova") u miratuan 220 ligje. Trembëdhjetë ligje të kësaj legjislature u dërguan për vlerësim të kushtetueshmërisë në GjK dhe dy vendime të Kuvendit, ndërsa u dërguan gjashtë draft amendament kushtetuese për t'u konfirmuar nëse ato nuk pakësojnë të drejtat e njeriut. Gjashtë projektligje u dërguan nga Lëvizja VETËVENDOSJE! (më tutje: LVV), në dy raste GjK vendosi se nenet e kontestuara janë në përputhje me Kushtetutën (Ligji për fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit), në një rast tjetër GjK konstatoi se procedura e ndjekjes nuk ishte në kundërshtim me Kushtetutën dhe se akti i kontestuar binte jashtë fushëveprimit të juridiksionit *ratione materiae* te Gjykates.[3] GjK, në një rast të këtij subjekti politik shpalli të pavlefshme disa nene të Ligjit për Amnisti[4], në një tjetër shpalli kërkesën të papranueshme dhe në një rast tjetër ajo hoqi nga lista kërkesën për arsye se kishin ndodhur ndryshime të shpejta legjislative që në mënyrë substanciale kishte ndikur në kërkesën e parashtruesit. Sa i përket shtatë rasteve te tjera, GjK shpalli të pavlefshëm dy paragrafë të Ligjit për Shëndetësi, shpalli të pavlefshme 5 nene të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, në një rast nuk gjeti shkelje të procedurës së nxjerrjes së ligjit, në një rast tjetër ligji i nxjerrë ishte në përputhje me kushtetutën, ndërsa tre kërkesa GjK i shpalli të papranueshme. Gjykata Kushtetuese, rrëzoi një nen të caktuar të Ligjit për Skemat Pensionale të miratuar në këtë legjislaturë si dhe kërkoi nga Qeveria dhe Kuvendi të miratonin ndryshimet e reja në mënyrë që qindra-mijëra pensionistë të mos vazhdojnë të diskriminohen.

---

[2] *Paragrafi 8, Neni 113* i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

[3] *Shqyrtimi i igjit, Nr. 04/L-199, për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombetare të parimeve që rregulojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje.* (Shih për më shumë Aktgjykimin e GjK-së: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ko_95_13_shq.pdf)

[4] *Shih për më shumë Aktgjykimin e GjK-së nga ky link: https://gjk-ks.org/decision/vlersim-i-kushtetutshmris-s-ligjit-nr-04l-209-pr-amnisti/*

GjK rrëzoi edhe Vendimin e Kuvendit lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, duke konstatuar se ky vendim është jo-kushtetues sepse nuk është realizuar procedura kushtetuese për zgjedhjen e tij.[5]

Legjislatura e katërt shënon numrin më të madh të kërkesave për konfirmim të amendamenteve kushtetuese të dorëzuara nëpërmjet Kryetarit të Kuvendit (gjashtë kërkesa me 49 amendament kushtetuese).

Në Legjislaturën e V-të (2014-2017, koalicioni qeverisës LDK-PDK) u miratuan 115 ligje, gjashtë ligje u dërguan në Gjykatën Kushtetuese prej të cilave tre nga Lista Serbe, një ligj nga tre grupet parlamentare bashkërisht LVV-AAK-NISMA, një nga Avokati i Popullit dhe një ligj nga Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (më tutje: KSDhPGjS) për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Në këtë legjislaturë u dërguan për vlerësim të kushtetuetshmërisë edhe tre vendime të Kuvendit, përderisa u dërguan dy kërkesa me draft amendamente kushtetuese.

GjK në tre rastet e inicuara nga Lista Serbe nuk gjeti shkelje kushtetuese sa i përket procedurës së ndjekur dhe përmbajtjes së ligjeve. Në rastin e dërguar nga LV-AAK-NISMA ajo gjeti se vetëm një paragraf i Ligjit për Vetëranët nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën, rastin e dërguar nga KSDhPGjS e kishte shpallur të papranueshme ndërsa kërkesën e AP, nenet e caktuara të Ligjit për Kundërvajtje në pajtim me Kushtetutën e Kosovës.

Tre vendime të Kuvendit në këtë legjislaturë u dërguan për t'u vlerësuar në GjK. Një vendim nga LVV-AAK-NISMA dhe një vendim tjetër i parashtruar ndaras nga LVV u shpallën të papranueshme. GjK, në rastin e dorëzuar nga Partia Demokrratike e Kosovës (më tutje: PDK) rrëzoi në tërësi vendimin e Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit.

Në këtë legjislaturë, u parashtruan edhe dy kërkesa për konfirmim të amendamenteve kushtetuese të dorëzuara nëpërmjet Kryetarit të Kuvendit.

Në Legjislaturën e VI-të (2017-2019, koalicioni qeverisës PDK-AAK-NISMA) u miratuan 109 ligje, përderisa në GjK u dërguan shtatë projektligje, prej të cilave një nga LVV, një tjetër bashkë nga LVV dhe LDK, katër projektligje nga AP dhe një projektligj nga Gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda, Gjykata Themelore në Prishtinë. Në GjK përfundoi për t'u vlerësuar kushtetuetshmëria e tij edhe një vendim i Kuvendit i cili u dërgua nga LVV dhe konfirmimi i amendamenteve kushtetuese nga Kryetari i Kuvendit.

Ligji nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi u dërgua nga deputetët e LVV-së, gjykata konstatoi se procedura e ndjekur është kushtetuese, ligji nuk është në kundërshtim me Kushtetutën, kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën dhe është jashtë fushëveprimit të juridiksionit të Gjykatës. Tutje, Ligji nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur

---

[5] *Aktgjykim në rastin KO 29/11, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës,* 28 mars 2021. (Shih këtë link: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Evidencaeligjeve_KkaXUuYb2e.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës u dërgua nga AP, për të cilin GjK pjesën më të madhe të neneve të këtij ligji i shpalli në papajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës. Ligji nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë u dërgua nga LVV-LDK, Gjykata e rrëzoi në tërësi për shkak se ky ligj nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën. Ligji i katërt në këtë legjislaturë që përfundoi në GjK ishte Ligji nr. 06/L-010 për Noterinë, disa nene të këtij ligji për të cilat GjK vendosi se nenet e kontestuara nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën. Ligji i pestë që u dëgua në Gjykatën Kushtetuese ishte Ligji për Gjykatat, kërkesë të cilën GjK e shpalli të papranueshme. Gjykata rrëzoi në tërësi Ligjin për Pagat në Sektorin Publik ndërsa Ligjin për Zyrtarët Publik, për dhjetëra nene të këtij ligji i shpalli në papajtueshmëri me Kushtetutën. Në rastin e dërguar nga LVV për t'u vlerësuar kushtetuetshmëria e Vendimit nr. 06/V-145 të Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me Propozimin e Grupit Parlamentar të LV-së për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, kjo gjykatë konstatoi se një vendim i tillë i Kuvendit është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

Në legjislaturën e VII-të (2019-2020, koalicioni qeverisës LV-LDK dhe 2020-2021, koalicioni qeverisës LDK-AAK-NISMA) u miratuan më së paku ligje, vetëm 17, por asnjëri nuk u kontestua në Gjykatën Kushtetuese. Në GjK u kontestua vendimi i Kuvendit të Kosovës nr. 07/V-014, të 3 qershorit 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Gjykata konstatoi se nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, sepse Qeveria nuk ka marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Gjykata po ashtu urdhëroi Presidentin për shpalljen e zgjedhjeve. Në dy raste tjera, GjK shpalli të pavlefshëm Vendimin e Qeverisë nr. 01/15 i datës i 23 mars 2020, meqenëse vendimi i tillë ishte në kundërshtim me Kushtetutën. GjK, pjesërisht shpalli të palevfshme disa vendime të Ministrisë së Shëndetësisë (Vendimit nr. 229/IV/2020, nr. 238/IV/2020, nr. 239/IV/2020 të datës14 prillit 2020.

Legjislatura e VIII, (2021 - vazhdon ende, LVV), është ajo në të cilën më së shumti u dërguan ligje dhe vendime të Kuvendit në Gjykatën Kushtetuese. Nga 201 ligje të miratuara deri më tani, në Gjykatën Kushtetuese janë dërguar për vlerësim të kushtetuetshmërisë dhjetë ligje, gjashtë vendime të Kuvendit dhe një vendim i Kryetarit të Kuvendit për thirrjen e seancës së rregullt plenare. Nga dhjetë (10) ligjet e dërguara, GjK ka rrëzuar tërësisht Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligjin për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg, pjesërisht ka rrëzuar Ligjin për Zyrtarët Publik dhe i ka hapur rrugë dekretimit pa ato nene ndërsa për Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme ajo ka konstatuar se nuk është në kundërshtim me Kushetutën.

GjK, ka shqyrtuar edhe disa vendime të Kuvendit të Kosovës, prej të cilave tre i ka shpallur në pajtueshmëri me Kushtetutën. Ajo ka rrëzuar vendimin e Kuvendit për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe dhe ka rrëzuar vendimin e Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së. Sipas GjK-së, nuk është çështje kushtetuese vendimi i Kryetarit të Kuvendit për thirrjen e seancës plenare të dt. 13 korrik 2023, rrjedhimisht këtë kërkesë e ka shpallur të papranueshme.

Në procedurë të shqyrtimit pranë GjK-së janë edhe gjashtë projektligje dhe një vendim i Kuvendit: Ligji për Pagat në sektorin publik, Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)

Nr. 08/L-032, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dheshkallët tatimore në të ardhurat personale vjetor, Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës Civil, Vendimi i Kuvendit të Kosovës për shkarkimin e Kimete Gashit nga pozita e anëtares së bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, dhe Ligji për Investimet e Qëndrueshme.

Raportet e ndryshme ndërkombëtare tregojnë se Kosova ka një Kushtetutë e cila përmban norma kushtetuese të cilat përgjithësisht janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Por, këto norma duhet të shkojnë përtej këtyre standardeve dhe jo e kundërta. Së fundi, edhe Raporti mbi përshtatjen e sistemit ligjor të Kosovës me standardet e Këshillit të Evropës ka rekomanduar që me rastin e propozimit të ligjeve të caktuara nga qeveria dhe miratimit të atyre ligjeve nga Kuvendi të merren për bazë rekomandimet e Këshillit të Evropës. Raporti evidenton probleme në lidhje me zbatimin e standardeve në praktikë.

4. Shkeljet kushtetuese në shkarkime

4.1 Shkarkimi i pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Me 21 qershor 2021, Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal (tutje: KAPPLMZhR), i rekomandoi Kuvendit të Kosovës mosmiratimin e Raportit vjetor për vitin 2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.[6] Në seancën plenare me 12 gusht 2021, me arsyetimin se raporti vjetor i punës nuk i përmbush obligimet ligjore për raportim, Kuvendit i rekomandohet mosmiratimi i tij. Në anën tjetër, edhe rekomandimi i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere si komision i përhershëm ishte që që ky raport të mos miratohet me arsyetimin se ai nuk i përmbush kriteret siç parashihen në Ligjin për menaxhimin e financave publike.[7] Në të njejtën seancë, Kuvendi me asnjë votë për, 57 vota kundër dhe 7 abstenime, nuk e miratoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (më tutje: KPMShCk) për vitin 2020.

Mosmiratimi i raportit në komision dhe më tutje në seancë plenare, bëri që Komisioni të kërkojë informata shtesë për punën e këtij Këshilli e që për pasojë në mbledhjen e Komisionit të mbajtur me 15 qershor 2021, vendosi t'i rekomandojë Kuvendit shkarkimin e pesë anëtarëve të këtij këshilli.[8] Në seancën plenare me 30 qershor 2021 me 62 vota për, 3 vota kundër dhe 11 abstenime, Kuvendi i Republikës së Kosovës mori vendim për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.[9]

---

[6] "Procesverbal i mbledhjes së Komisionit". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 1 qershor 2021. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/5.Procesverbalishqip01.06.2021_szqDsMNJ3C.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

[7] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit, fq. 3". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 12 gusht dhe 4 tetor 2021. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021_08_12_ts_Seanca_01_eUv5F4Pc5V.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

[8] "*Procesverbal i mbledhjes së Komisionit*". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 15 qershor 2021. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/6.Procesverbalishqip15.06.2021_pe2ML4Mt3p.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

[9] "*Transkript i seancës plenare të Kuvendit*, fq. 63". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 30 qershor 2021. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021_06_24_ts_Seanca_JmNCzadYPq.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, pas vlerësimit të kërkesës së deputetëve të Kuvendit në lidhje me kushtetuetshmërinë e këtij vendimi, me 9 dhjetor 2021 mori Aktgjykimin në rastin nr. K0127/21[10] ku konstatoi se vendimi ishte në papajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës si dhe shfuqizoi vendimin për shkarkimin e tyre.

Gjykata gjeti se Kuvendi kishte bërë tejkalim të kompetencave të Kuvendit sa i përket Nenit 65, paragrafit 9 të Kushtetutës në kuptim të cenimit të garancive institucionale të Këshillit të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës. Tejkalimi i kompetencës vërehet në mbledhjen e Komisionit për Administratë në pyetjet e deputetëve, anëtarë të këtij komisioni ku ata në të shumtën e rasteve, parashtruan pyetje që lidhen me përmbajtjen e vendimeve të KPMShCk-së[11], pyetje të cilat sipas Gjykatës Kushtetuese përbëjnë ndërhyrje në pavarësinë e KPMSHCK-së lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore.[12]

5. Cenimi i pavarësisë së organeve të themeluara me kushtetutë

5.1 Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Me 24 mars 2023, Gjykata Kushtetuese shpalli të pavlefshëm në tërësine e tij ndryshimet e bëra nga ana e Kuvendit të Kosovës në Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Sipas GjK-së, ligji i miratuar nga Kuvendi, i sponsorizuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë nuk ishte në përputhshmëri me formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, cenon pavarësinë e funksionimit të KPK-së, cenonte parimet e ndarjes dhe balancit të pushteteve dhe cenonte pavarësinë funksionale të KPK-së si dhe cenonte sigurinë e mandateve të anëtarëve të Këshillit Prokurorial.[13]

Me 12 korrik 2023, Qeveria dërgoi për në Kuvendin e Kosovës propozimet e reja për Ligjin Prokurorial të Kosovës. Të njejtin projektligj, me 30 korrik 2023 Kryetari i Kuvendit nën arsyetimin se drafti i propozuar ka pësuar ndryshime që nga vlerësimi i Komisionit të Venecias, ai dërgoi këtë projektligj në këtë këtë institucion për të marrë opinionin e tyre.

5.2 Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Me 12 tetor 2023, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr.08/L-180 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Përkitazi me këtë Projektligj, para miratimit të tij në lexim të parë, IKD në analizën

---

[10] *Aktgjykim në rastin KO127/21, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës*, 9 dhjetor 2021. (https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/12/ko_127_21_agj_shq.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

[11] *Shih pyetjen e parë të deputetit Besim Muzaqi ndaj Eshref Shabanit, Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,* https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/5.Procesverbalishqip01.06.2021_szqDsMNJ3C.pdf).

[12] *Pika 118, Aktgjykim në rastin KO127/21*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 2 gusht 2023. (https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/12/ko_127_21_agj_shq.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

[13] *Aktgjykim në rastet nr. KO100/22 dhe KO101/22*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 24 mars 2023. (https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/ko_100_101_22_agj_shq.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

"Tendencat për politizim të KPMShCK" kishte gjetur se i njëjti cenon pavarësinë kushtetuese të KPMShCK-së, ngushton funksionin e tij, i kufizon kompetencat dhe përgjegjësitë që i garanton Kushtetuta dhe në anën tjetër ky ligj i hap rrugë politizimit të sektorit publik në Kosovë, pasigurisë juridike dhe arbitraritetit ndaj zyrtarëve publik.[14] Tutje, sipas Projektligjit, KPMShCK nuk do të ketë kompetencë të vendosë për ankesat kundër vendimit të Qeverisë për nëpunësit civilë në pozitat e larta drejtuese. Projektligji synon që t'ua marr imunitetin funksional Kryetarit dhe anëtarëve të KPMShCK, e që marrja e imunitetit për kryetarin dhe anëtarët e KPMShCK drejt për së drejti cënon pavarësinë e këtij institucioni si dhe cënon të drejtat e palëve.

Për shkak të problemeve të njejta të identifikuara në raportin e IKD-së, me 20 tetor 2023 brenda afatit kushtetues grupi parlamemtar i PDK-së ligjin e lartëcekur e dërgon në Gjykatën Kushtetuese për arsye se i njejti nuk është në pajtim me Aktgjykimin e GjK-së në rastin KO171/18, nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës, organin e pavarur kushtetues e kthen në një mekanizëm që i legjitimon, përkrahë dhe nuk i ndalon punësimet politike. Tutje, ligji i miratuar zhvesh nga imuniteti të gjithë anëtarët e KPMShCK-së, përjashtohen nga fushëveprimi i kontrollit të ligjshmërisë nga ana e Këshillit pozitat e nivelit të lartë drejtues.

5.3 Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së pajustifikueshme

Me 9 shkurt 2023, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr.08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme.[15] Gjatë leximit të parë, pas kërkesave të kryetarëve të grupeve parlamentare opozitare, Kryetari i Kuvendit dërgoi këtë projektligj në Komisionin e Venecias për të marrë opinionin e tyre.[16] Përkitazi me këtë Projektligj, gjatë shqyrtimit të parë dhe në lexim të dytë, deputetët e grupeve parlamentare opozitare, veçanërisht grupit të PDK-së paraqitën vërejtje për këtë projektligj se i njejti përmban të meta kushtetuese.

Vërejtjet thelbësore për Projektligjin janë pasqyruar edhe në Raportin e IKD-së me titull "Konfiskimi i pasurisë së pajustifikueshme: problemet juridike të Projektligjit aktual"[17], vërejtje të cilët më pastaj u pasqyruan edhe nga Komisioni i Venecias në opinionin e tyre me dt. 17-18 qershor 2022.[18]

---

[14] *Shala G. Tendencat për politizim të KPMShCK*, Prishtinë. Nëntor 2022. (Shih linkun: https://kli-ks.org/tendencat-per-politizim-te-kpmshck/). (Qasur për herë të fundit më 2 nëntor 2023).

[15] *Vendim për miratimin e Ligjit nr.08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme*, Kuvendi i Kosovës, 2023. (https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/121Vendim_Ez8jYFuKYy.pdf). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).[16] *Kuvendi shqyrtoi Projektligjin për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustifikueshme*, 2022. (https://kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/kuvendi-shqyrtoi-projektligjin-per-byrone-sht-28982/). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[17] *Shala G. dhe Hasani J., Konfiskimi i pasurisë së pajustifikueshme: problemet juridike të Projektligjit aktual, Prishtinë. Nëntor 2023.* (Shih linkun: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/01/IKD_Raporti_Konfiskimi-i-Pasurise-se-pajustifikueshme-problemet-juridike-te-projektligjit-aktual-19.01.2022.pdf). (Qasur për herë të fundit më 2 nëntor 2023

[18] *Venice Commission, "Kosovo - Opinion on the Draft Laë N° 08/L-121 on The State Bureau for verification and confiscation of unjustified assets*, adopted by the Venice Commission at its 131st Plenary Session."

Gjetjet e IKD-së tregojnë që autoriteti për implementimin e Projektligjit, nuk është I pavarur në kuptimin objektiv, kompetencat hetuese të Byrosë për mbledhje të informacioneve nuk janë plotësisht në harmoni me Kushtetutën, ka mungesë adekuate të kontrollit gjyqësor ndaj masave që Byroja mund t'i ndërmarrë. Tutje, sipas projektligjit centralizohet kompetenca për shqyrtimin gjyqësor (Gjykata Themelore në Prishtinë dhe në shkallë të dytë, Gjykata e Apelit), projektligji gjatë zbatimit mund të cenojë të drejtës e gëzimit paqësor të pasurisë.

Projektligji nuk rregullon në mënyrë më adekuate raportin e procedurës së konfiskimit civil me procedurat penale që mund të zhvillohen ndaj pronarit të pasurisë, caktimi i masës së përkohshme të sigurimit nuk respekton në tërësi të drejtën e pales në pronë.

Me 21 shkurt 2023, nën pretendimin për shkelje kushtetuese, Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme u dërgua nga Partia Demokratike e Kosovës për t'u vlerësuar kushtetuetshmëria e tij në Gjykatën Kushtetuese. [19]

6. Cenimi i pavarësisë së organeve të themeluara me ligj

6.1 Cenimi i pavarësisë së transmetuesit publik

Kuvendi i Kosovës, me rekomandim të Komisionit për Administratë Publike dhe me rekomandim të Komisionit për Buxhet, nuk e kishte miratuar Raportin vjetor të RTK-së për vitin 2020. Për pasojë Komisioni për Administratë Publike kishte rekomanduar edhe shkarkimin kolektiv të Bordit të RTK-së, përkatësisht të tetë 8 anëtarëve të Bordit të RTK-së. Kuvendi, me 21 korrik 2021 shkarkoi 8 anëtarët e Bordit.

Duke vepruar sipas autorizimeve në Nenin 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, një grup deputetësh kishte dërguar kërkesën për vlerësimin e kushetuetshmërisë së Kuvendit. GjK, me 1 gusht 2023 nxori Aktgjykimin në rastin nr. K0134/21[20] përmes së cilit shpalli vendimin e Kuvendit të Kosovës në mospërputhshmëri me paragrafin 1 Nenit 7 dhe paragrafi 9, të nenit 65. Sipas Gjykatës, Kuvendi tejkaloi kompetencat e përcaktuara në ligjin që vet e ka miratuar, përkatësisht Ligjin për RTK-në.

Sipas Gjykatës, në asnjë rrethanë nuk mundet Kuvendi që të shkarkojë në tërësi Bordin e RTK-së ngase një shkarkim i tillë është në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit për RTK-në. Mandati i anëtarëve është me kohëzgjatje të ndryshme dhe sipas ligjit, nuk duhet të jenë të zgjedhur në të njejtën kohë, ngase qëllimi i ligjit kur është miratuar ka qenë që momenti kur të zgjidhen të mos bëhet në të njejtën kohë dhe jo nga e njëjta shumicë parlamentare. Gjykata ka gjetur më tutje se Kuvendi i shkarkoi anëtarët e Bordit pa asnjë bazë të saktë ligjore. Është thelbësore sipas gjykatës që një dispozitë e tillë të jetë shprehimisht në ligj.

---

[19] *EKSKLUZIVE: PDK dërgon Projektligjin për Byronë në Gjykatën Kushtetuese*, 2022. (https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-pdk-dergon-projektligjin-per-byrone-ne-gjykaten-kushtetuese/). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[20] *Aktgjykim në rastin KO134/21*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 2 gusht 2023. (https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/09/ko_134_21_agj_shq.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

6.2 Cenimi i të drejtave të njeriut

Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, sipas të cilit Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (tutje: ANJF), do të inkorporohej si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Me këtë veprim të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, ndihma juridike pësoi dëm të madh dhe degradim të një institucioni për shkak të politizimit kundërkushtetues të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Në raportin me titull "Politizimi kundër kushtetues i ANJF", IKD gjente se inkorporimi i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në Ministrinë e Drejtësisë është bërë në kundërshtim me kushtetutën, për më tepër vendosja e ANJF-së si agjenci ekzekutive në kuadër të MD-së, do ta politizojë sistemin e ndihmës juridike falasa. Më tutje, sipas analizës kërkesat e qytetarëve do të trajtohen nga një institucion që udhëhiqet nga një i emëruar politik dhe për më keq kur kriteret për ofrimin e ndihmës juridike nga OJQ do të përcaktohen nga Ministria e Drejtësisë.

Një konstatim të njejtë e dha edhe Avokati i Popullit, sipas të cilit vendosja e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë (MD) nuk është avancim por degradim dhe regres.[21] Por, përkundër konstatimit të tij se ndihma juridike falas e vendosur në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë përbën regres në raport me rregullimin e mëparshëm dhe përkundër kërkesës së IKD-së që një ligj të tillë ta dërgojë në Gjyktën Kushtetuese, ai nuk ushtroi të drejtën e tij si palë e autorizuar.

7. Cenimi i përgjegjësive komunale

7.1 Cenimi i përgjegjësive komunale në arsim

Në vitin 2021, Komuna e Kamenicës, kishte marrë vendim për riorganizimin e procesit të mësimit në disa shkolla fillore të saj. Këto vendime ishin të njohura si reformë e thellë në arsimin lokal të kësaj komune. Vendimet kishin për qëllim caktimin e vijueshmërisë së mësimit nga disa shkolla përkatëse në lokacione tjera. Reforma e tillë ishte inicuar me arsyetimin se numri i nxënësve në disa fshatra është në rënie të madhe e në disa shkolla kishte më pak se pesë nxënës në të gjithë shkollën. Por, me nisjen e zbatimit në teren të reformës, kishin nisur pakënaqësitë e disa prindërve dhe pas inspektimit të Inspektoratit të Arsimit kishte rezultuar se disa fëmijë nuk kishin vijuar procesin mësimor për afër një vit, sepse prindërit e këtyre fëmijëve nuk ishin pajtuar me riorganizimin.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (tutje: MAShtTI) pas gjetjeve të Komisionit ad-hoc në këtë komunë, kishte nxjerrë Vendimin për organizimin e mësimit alternativ të pershpejtuar për 441 nxënësit e Komunës së Kamenicës", përmes të cilit kishte organizuar mësimin alternativ të përshpejtuar në pesë (5) shkolla dhe paralele përkatëse në Komunën e Kamenicës, të cilat, ishin riorganizuar tashmë përmes vendimeve të Komunës së Kamenicës.

---

[21] *Qelaj: Vendosja e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në kuadër të MD-së është degradim*, Betimi për Drejtësi, 2022. (https://betimiperdrejtesi.com/qelaj-vendosja-e-agjencise-per-ndihme-juridike-falas-ne-kuader-te-md-se-eshte-degradim/). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

Pas kërkesës së Komunës së Kamenicës, e cila ushtroi të drejtën e saj, ajo arriti të bind Gjykatën Kushtetuese në shfuqizimin e vendimit të kontestuar. Gjykata konstatoi se MASHTI kishte ndërhyrë në kompetenca komunale në lidhje me administrimin dhe ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm.[22] Më konkretisht, gjykata gjeti se vendimi i kontestuar ishte në papajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 12, paragrafin 1 dhe 3 te nenit 123 dhe paragrafin 2 dhe 3 të nenit 124 të Kushtetutës së Kosovës.

Ofrimi i arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative dhe punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit janë kompetencë themelore e Komunave, për të cilat MASHTI ka ndërhyrë në kompetencat e plota dhe eksluzive të komunave, ashtu siç parashihet shprehimisht edhe me Ligjin Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës.[23]

Në një rast tjetër, MASHTI kishte nxjerrë Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) nr. 104/2020 për Kriteret dhe Procedurat e Themelimit dhe Pushimit të Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit Parauniversitar,[24] përmes të cilit ajo i atribuonte vetes kompetenca në hapjen, mbylljen dhe organizimin e shkollave në nivelin parafillor, fillor dhe të mesëm.

Kompetencat e MASHTI-t, parashihnin që Sekretari i Përgjithshëm i kësaj minsitrie të kishte të drejtën e vendosjes për për propozimin e komunës në lidhje me verifikimin e kushteve për zhvillimin e veprimtarisë edukative-arsimore në komuna. Për më tepër, ushtrimi i ankesës nga komunat në rast të refuzimit të propozimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm do të bëhej në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Gjykata Kushtetuese në këtë rast, tregoi se MASHTI nuk mund t'i përcaktojë vetes kompetenca që nuk i janë përcaktuar me ligj të miratuar nga Kuvendi i Republikës, e e të cilat kompetenca mund të ndërhyjnë në veprimtarinë e vetëqeverisjes lokale në fushën e e arsimit apo të cenojnë përgjegjësitë komunale në këtë fushë.

Pas kërkesës së Komunës së Kamenicës, GjK me 7 dhjetor 2022, nxori Aktgjykimin në rastin KO173/21[25] me ç'rast ajo pjesërisht shpalli në papajtueshmëri me Kushtetutën, Udhëzimin Administrativ Nr. 104/2020.

Gjetjet e GjK-së konstatonin cenim të përgjegjësive komunale dhe në kompetencat vetanake të komunës për faktin se asnjë autoritet qendror, duke përfshirë këtu edhe

---

[22] *Aktgjykim në rastin KO145/21*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 9 dhjetor 2021. (https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2022/04/ko_145_21_agj_shq.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).
[23] *Neni 4, paragrafi 1 i Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës.* (https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2543). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).
[24] *I qashëm nga ky link:* https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ua-me-nr-104-kriteret-dhe-procedurat-te-themelimit-dhe-pushimit-te-veprimtaris-se-institucioneve-te-arsimit-parauniverzitar-1-rotated-1.pdf. (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).
[25] *Aktgjykim në rastin KO173/21, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës*, 7 dhjetor 2022. (https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/ko_173_21_agj_shq.pdf) . Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

edhe Ministrinë e Arsimit, nuk mundet që përmes akteve nënligjore t'i përcaktojë vetes kompetenca që nuk i janë përcaktuar me ligj të miratuar nga Kuvendi i Republikës. Për më tepër, nenet e kontestuara të UA cenojnë përgjegjësitë komunale për ofrimin e arsimit publik parauniversitar.[26]

7.2 Cenimi i të drejtës në shpenzim të të hyrave vetanake komunale nga vitet paraprake

Instituti i Kosovës për Drejtësi, në një rast tjeter ka gjetur se në kundërshtim me Kushtetutën dhe duke u arsyetuar në miratimin e një neni të caktuar në Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2023[27], Qeveria nuk i kishte transferuar të hyrat vetanake të komunave, duke bërë që mjetet, të cilat komunat i kanë mbledhur nga vitet e tjera paraprake (2021 e më poshtë) të bëhen pjesë e buxhetit qendror dhe jo të përdoren për shpenzime të komunave siç kishte qenë praktikë e mëhershme.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, komunat e kanë të drejtën e vendosjes, caktimit, mbledhjes dhe shpenzimit të të hyrave vetanake dhe në të njëjtën kohë të marrin fonde nga Qeveria e Kosovës.[28]

Pas ankesave të deputetëve nga grupet parlamentare opozitare dhe nga kryetarë e komunave se ligjin e tillë do ta dërguan në Gjykatën Kushtetuese për shkak të cenimit të kushtetuetshmërisë që bënte Neni 9 i Ligjit për Ndarjet Buxhetore, me 8 qershor 2023 Qeveria e Kosovës dërgoi për në Kuvendin e Kosovës projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e buxhetit përmes së cilit u adresuan ankesat e kryetarëve të komunave dhe të deputetëve të grupeve parlamentare opozitare. Rrjedhimisht, qeveria së bashku me deputetët evituan dërgimin edhe të një ligji në gjykatën kushtetuese.

8. Mos-ushtrimi i kompetencës kushtetuese të Avokatit të Popullit dhe deputetëve të Kuvendit

Të dhënat publike në faqen e Gjykatës Kushtetuese tregojnë se që nga viti 2010, Avokati i Popullit i ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese 9 lëndë të cilat kanë pasur të bëjnë me kontestim të kushtetuetshmërisë së ligjeve të nxjerra nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Ish-Avokati i Popullit, Sami Kurteshi ka dërguar tre lëndë për pesë vite mandat të tij, ish-Avokati i Popullit, Hilmi Jashari ka dërguar 5 lëndë për pesë vite mandat të ushtrimit të funksionit dhe Avokati aktual i Popullit, ka dërguar një ligj në Gjykatën Kushtetuese për më shumë se tre vite të ushtrimit të mandatit të tij

---

[26] *Pika 263, Aktgjykim në rastin KO173/21*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 7 dhjetor 2022. (https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/ko_173_21_agj_shq.pdf) . Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).
[27] *Paragrafi 6, Neni 9 i Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023.* (https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Ligjinr.08-L-193_8LfECëGhNf.pdf). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).
[28] Paragrafi 3, Neni 24 i Kushtetutës së Kosovës, 2008. (https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

9. Ligjet e tjera në procedurë të vlerësimit nga Gjykata Kushtetuese

Përveç ligjeve që tashmë Gjykata Kushtetuese ka dhënë një vendim meritor, disa ligje të tjera ndodhen në procedurë të vlerësimit. Shumicën e ligjeve të kontestuara janë të dërguara nga grupet parlamentare opozitare (PDK, LDK dhe AAK), përderisa një projektligj është dëguar nga Avokati i Popullit dhe një ligj nga Gjykata Supreme e Kosovës. Në dy raste, falë punës së Institutit të Kosovës për Drejtësi, Kuvendi arriti t'i adresojë rekomandimet e publikuara në analizën e publikuar me titull "Masat Represive për Mbrojtjen e Grave", e cila u ishte dërguar të gjithë deputetëve e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

9.1 Kontestueshmëria e Ligjit të Pagave në Sektorin Publik

Në muajin dhjetor 2022, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr.08/L-196 për pagat në sektorin publik. Projektligji u miratua me procedurë të përshpejtuar.[29] Përkundër qëllimit të mirë dhe premtimit për reformë në administratën publike nga ana e Qeverisë së Kosovës, IKD më 22 dhjetor 2022 publikoi analizën "Pagat në Sektorin Publik" në të cilën analizë gjetjet treguan për probleme serioze kushtetuese të këtij ligji.

Ligji i miratuar ishte në kundërshtim me Aktgjykimin e GjK-së në rastin nr. KO219/19, cenonte sigurinë juridike të nëpunësve të sektorit publik, duke mos përcaktuar vlerën monetare të koeficientëve. Tutje, ligji në mënyrë kundër kushtetuese ulte pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, në disa raste ligji përmban dispozita të cilat paraqesin trajtim të pabarabartë të nëpunësve të sektorit publik, aspekt ky që paraqet shkelje të nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Përfundimisht, sipas analizës së IKD-së ligji i miratuar përmban dispozita të cilat cenojnë pavarësinë funksionale të sistemit të drejtësisë, i cili cenim paraqet shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. IKD, analizën e plotë e kishte dërguar te të gjithë deputetët para miratimit në lexim të parë të këtij ligji.

Me 6 janar 2023, IKD përmes një shkrese zyrtare dhe publike kërkoi nga Avokati i Popullit për fillimin e hetimeve për shkelje të të drejtave të njeriut dhe inicim në Gjykatën Kushtetuese të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.[30] Kërkesa te Avokati i Popullit dorëzuan edhe 104 sindikata dhe organizata të ndryshme në Kosovë.

Kërkesa ishte e njejtë, dërgimi i Ligjit për Paga në Gjykatën Kushtetuese. Dhe vetëm pas arritjes së numrit mbi 100 ankesa dhe presionit të madh publik nga organizatat e punës, Avokati i Popullit me 7 prill 2023[31], dërgoi ligjin e pagave në Gjykatën Kushtetuese.

---

[29] Transkript i seancës plenare të Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 15 dhjetor 2022. (Shih linkun https://www.assembly-kosova.org/Uploads/Data/SessionFiles/2022_12_15_ts_Seanca,ora14.00_2gy8gjjvHy.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

[30] *IKD ka deponuar kërkesën tek Avokati i Popullit që ta procedojë Ligjin për Pagat në Sektorin Publik në Gjykatën Kushtetuese*, IKD Prishtinë, 2023. (Shih linkun https://kli-ks.org/ikd-ka-deponuar-kerkesen-tek-avokati-i-popullit-qe-ta-procedoje-ligjin-per-pagat-ne-sektorin-publik-ne-gjykaten-kushtetuese/). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

[31] *Komunikatë për media - Avokati i Popullit dërgoi në Gjykatën Kushtetuese Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me kërkesë për vlerësimin e përputhshmërisë së tij me Kushtetutën, IAP Prishtinë, 2023.* (Shih linkun https://oik-rks.org/2023/04/07/komunikate-per-media-avokati-i-popullit-dergoi-ne-gjykaten-kushtetuese-ligjin-nr-08l-196-per-pagat-ne-sektorin-publik-me-kerkese-per-vleresimin-e-perputhshmerise-se-tij-me-kushtetuten/). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

9.2 Pretendimet për ndërhyrje arbitrare në parimet dhe vlerat e ekonomisë së lirë

Me 8 nëntor 2022, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr.08/L-179 për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg.[32] Përkitazi me këtë Projektligj, gjatë shqyrtimit të parë[33] poashtu edhe në lexim të dytë, deputetët e grupeve parlamentare opozitare, veçanërisht grupit të LDK-së kishin paraqitur vërejtje për këtë projektligj se i njejti përmban të meta kushtetuese, ndërhyrje arbitrare në parimet dhe vlerat e ekonomisë së lirë.

Grupi parlamentar i LDK-së me 16 nëntor 2022, dërgoi ligjin në Gjykatën Kushtetuese.[34] Sipas LDK-së, deputetes së saj Hykmete Bajrami, ky ligj nuk është në pajtim me nenin 10 të Kushtetutës, sipas të cilit "Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës." Përmes këtij ligji, cenohen komponentët kryesorë të ekonomisë së tregut e që janë: prona private, zgjedhja e lirë e aktivitetit, konkurrenca dhe fitimi, si forcë lëvizëse.[35]

Me 8 nëntor 2023, rrëzoi në tërësi ligjin e kontestuar, për të cilin ajo konstatoi se nuk është në përputhshmëri me vlerat, ekonominë dhe parimet e përgjithshme të Kushtetutës.[36]

9.3 Pretendimet për cenim të përgjegjësive komunale në vjeljen e të hyrave vetanake

Në janar të vitit 2023, qytetarëve të Kosovës i'u dërguan faturat e reja të tatimit në pronë të cilat pas vlerësimit të përgjithshëm të pronave në nivel vendi në fund të vitit 2022 të bërë nga Departamenti për Tatimin në Pronë, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (tutje: MFPT), ato në të shumtën e rasteve u dyfishuan dhe në shumë raste u trefishuan.[37] Për shkak të kësaj rritjeje, qytetarët patën ankesa të shumta sepse ata nuk mund të përballonin një rritje të tillë. Për këto fatura reaguan komunat e Kosovës dhe një pjesë e madhe e deputetëve të Kuvendit.

Kuvendi i Kosovës, debatoi për rritjen e tatimit në pronë me 16 shkurt 2023,[38] ku kërkesa kryesore e një pjese të deputetëve ishte që rivlerësimi i bërë për vitin 2022 të pezullohet e në ndërkohë të zbatohet vlerësimi i bërë për vitet paraprake.

---

[32] *Vendim për miratimin e Ligjin nr.08/L-179 për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg*, Kuvendi i Kosovës, 2022. (https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/179Vendim_eeaPLDDGSm.pdf). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).
[33] *Transkript i seancës plenare të Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës*, 30 qershor 2022. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021_06_24_ts_Seanca_JmNCzadYPq.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).
[34] *LDK-ja dorëzon në Kushtetuese Ligjin për caktimin e çmimeve tavan*, Koha, 2022. (https://www.koha.net/arberi/352831/ldk-ja-dorezon-ne-kushtetuese-ligjin-per-caktimin-e-cmimeve-tavan/). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).
[35] *Transkript i seancës plenare të Kuvendit*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 20 tetor 2022. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2022_10_14_ts_Seanca,ora15.00_LEss42aYME.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).
[36] *Aktgjykim në rastin KO173/22*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 8 nëntor 2023. (https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/11/ko_173_22_agj_shq.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).
[37] *"Faturat e tatimit në pronë alarmojnë qytetarët"* 2023, Koha. (https://www.koha.net/arberi/362646/faturat-e-tatimit-ne-prone-alarmojne-qytetaret/). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).
[38] "*Transkript i seancës plenare të Kuvendit*". Kuvendi i Republikës së Kosovës, 16 shkurt 2023. (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_02_16_ts_Seanca_92ct3K4mTq.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

Shoqëria civile poashtu kërkoi që rivlerësimi të shfuqizohet dhe një proces i ri i ri-vlerësimit të përgjithshëm të pronave të bëhet në vitin 2025[39], ngase Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, ka lënë mundësinë që ri-vlerësimi të bëhet edhe cdo pesë vite përderisa vlerësimi që u bë ishte në vitin e tretë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.[40]

Kërkesat e kryetarëve të komunave, të një pjese të deputetëve dhe një pjesë e shoqërisë civile nuk u morën parasysh nga Qeveria e Kosovës. Ajo me 4 prill 2023, u dërgoi deputetëve të Kuvendit të Kosovës Projektligjin nr.08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme. Qëllimi i projektligjit kishte për qëllim të sigurojë progresivitet të shkallës tatimore, lirim tatimor për vendbanimin parësor dhe tokat bujqësore, faljen tatimore për vitin tatimor 2023 dhe rregullat kufizuese për aplikimin e detyrimit tatimor, dhe interesit.[41] Ligji i miratuar, u mundëson komunave t'ua falin borxhet deri 100 euro komunave, të cilat deri më 15 shtator do të duhej të merrnin vendim për këtë çështje. Projektligji u kundërshtua nga opozita parlamentare se i njejti shkelte Kushtetutën e Kosovës, konkretisht sipas tyre cenonte kompetencën e të hyrave vetanake për të cilat sipas Kushtetutës përgjegjëset e vetme dhe eksluzive janë komunat e Kosovës. Dhe nën pretendimin për shkelje Kushtetuese, Kryetari i komunës së Prizrenit e dërgoi këtë projektligj në Gjyktën Kushtetuese për të vlerësuar disa dispozita të këtij ligji.

Me 15 nëntor 2023, Gjykata vendosi që neni 5 i Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me Kushtetutën, nuk cenon kompetencën e të hyrave vetanake.[42]

9.4 Pretendimet për shkelje të vlerave, barazisë para ligjit, mbrojtjes së pronës, të drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit dhe mbrojtjes shëndetësore dhe sociale

Sipas Ligjit të Punës, caktimi i pagës minimale bëhet në fund të çdo viti kalendarik me vendim të Qeverisë së Kosovës, pas propozimit nga Këshilli Ekonomiko Social përmes Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (tutje: MFPT). Duke qenë se sindikatat nuk u pajtuan me shumën e propozuar nga MFTP, sindikatat nuk votuan këtë shumë rrjedhimisht propozimi nuk u procedua për në Qeverinë e Kosovës sepse me Ligjin për Këshillin Ekonomiko Social, vendimet e këtij organi miratohen me 2/3 e votave të anëtarëve të përhershëm të KES- it.[43]

Me arsyetimin se një pengesë e tillë ligjore po pamundëson procedimin e pagës minimale, Qeveria e Kosovës procedoi për në Kuvendin e Kosovës Ligji nr.08/L-142

---

[39] *IKD-ja i kërkon qeverisë ta pezullojë dyfishimin e tatimit në pronë deri më 2025*, Koha. (https://www.koha.net/arberi/366578/ikd-ja-i-kerkon-qeverise-ta-pezulloje-dyfishimin-e-tatimit-ne-prone-deri-me-2025/). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).
[40] *Neni 18 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15984). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).
[41] *Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme*, 2023, Kuvendi i Republikës së Kosovës. (https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperndrysheligjitpertatiminnepronenepaluajteshme_Bg6tYNALVX.pdf). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).
[42] *Aktgjykim në rastin KO177/23, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës*, 15 nëntor 2023. (https://gjk-ks.org/decision/vleresimi-i-kushtetutshmerise-se-nenit-5-te-ligjit-nr-08-l-224-per-ndryshimin-dhe-plotesimin-e-ligjit-nr-06-l-005-per-tatimin-ne-pronen-e-paluajtshme/). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).
[43] *Paragrafi 1, Neni 17, Ligji Nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social*, 2011, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2747). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

i cili do të ndryshonte dhe plotësonte disa ligje që do të përcaktonte procedurën e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore. Projektligji, do të shmangte në një fazë edhe Këshillin Ekonomiko Social për caktimin e pagës minimale, sepse sipas ligjit në rast të pamundësisë së arritjes së konsensusit në KES, MFTP do të kishte të drejtën e propozimit të shumës së pagës në Qeveri pas një njoftimi formal për KES-in. Veteranët e UÇK-së, personat e verbër, personat paraplegjik dhe tetraplegjik do të hiqeshin nga lidhja me shumën e pagës minimale.[44]

Pas përplasjeve të mëdha ndërmjet opozitës dhe Qeverisë, Kuvendi kishte arritur ta votone me vonesë procedurale prej 9 muajve këtë projektligj. Por, brenda afatit kushtetues prej tetë ditëve nga dita e fundit e miratimit të ligjit, grupi parlamentar i AAK-së ligjin në fjalë e kishte proceduar me kërkesën për vlerësim të Kushtetuetshmërisë në Gjykatën Kushtetuese. Sipas këtij grupi, ligji i cenonte vlerat, barazinë para ligjit, cenonte mbrojtjen e pronës, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit dhe mbrojtjet shëndetësore dhe sociale.

9.5 Pretendimet për shkelje kushtetuese në shkarkimin e anëtares së Bordit të OShP-së

Me 13 korrik 2023, Kuvendi i Kosovës me 58 vota për, 1 kundër dhe dy abstenime shkarkoi Kimete Gashin nga pozita e anëtares së bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Shkarkimi i saj u kundërshtua nga partitë opozitare parlamentare. Njëra nga to, LDK, mbi pretendimet për shkelje kushtetuese në shkarkim të saj, me 20 korrik 2023 dërgoi në Gjykatën Kushtetuese vendimin e Kuvendit. Sipas LDK-së, ata kontestojnë lëndën si për nga forma dhe procedura e nxjerres së vendimit po ashtu edhe për nga përmbajtja e tij. Vendimi ka kundër-kushtetuetshmëri dhe kundërligjshmëri për të cilën GjK duhet t'i vërtetojë pretendimet.[45]

9.6 Pretendimet për shkelje kushtetuese tek Projektligji për Investime të Qëndrueshme

Me 9 nëntor 2023, deputetët e grupit parlamentar të PDK-së dërguan në GjK kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme.[46] Pretendimet e një pjese të grupit parlamentar të PDK-së kanë të bëjnë me shkelje të vlerave, barazisë para ligjit, më tutje shkelje të parimeve të përgjithshme dhe të Nenit 122 (Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Njerëzore). Kuvendi i Kosovës, këtë ligj e miratoi në seancën plenare të mbajtur me 19 tetor 2023.

---

[44] *Projektligji nr.08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore*, 2022, Kuvendi i Kosovës. (https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperproceduratpercaktiminepagesminimaledheshkallatatimoreneTPV_sAk8chU6h6.pdf). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[45] *Përfundon në Kushtetuese edhe shkarkimi i Kimete Gashit*, Kosovapress. (https://kosovapress.com/%E2%80%8Bperfundon-ne-kushtetuese-edhe-shkarkimi-i-kimete-gashit/). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[46] *Ekskluzive: PDK e dërgon në Gjykatë Kushtetuese edhe Projektligjin për Investime të Qëndrueshme*, Betimi për Drejtësi. (https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-pdk-e-dergon-ne-gjykate-kushtetuese-edhe-projektligjin-per-investime-te-qendrueshme/). (Qasur për herë të fundit me 26 nëntor 2023).

10. Zbatimi i kërkesave të Gjykatës Kushtetuese nga institucionet publike

10.1 Shkelja e të drejtave të pensionistëve nga vonesat në miratimin e ligjit për skemat pensionale

Me 30 dhjetor 2022, Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KO190/19, shfuqizoi paragrafin 2 të nenit 8 te Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale, sepse në mënyrë diskriminuese përmes këtij neni mijëra qytetarë duke mos e përmbushur kriterin e përvojës prej 15 viteve pune para janarit të vitit 1999 nuk e kanë gëzuar pensionin kontributdhënës, por vetëm atë të moshës. Gjykata urdhëroi Kuvendin dhe Qeverinë, që jo më larg se data 15 korrik 2023, të ndërmarrin veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji dhe se këto dispozita do të shfuqizohen me 15 korrik 2023.

Qeveria dhe Kuvendi, edhe pse ishin në dijeni të Aktgjykimit sepse i njejti u ishte dorëzuar, një projektligj i tillë nuk ishte përfshirë në Programin Legjislativ për vitin 2023.[47] Vetëm në ndryshimin dhe plotësimin e pestë të programit legjislativ për vitin 2023, Qeveria vendosi që miratimi i projektligjit për skemat pensionale të hyjë në agjendën legjislative dhe atë që këto ndryshime të ndodhnin me 30 korrik 2023 — 15 ditë me vonesë.

Qeveria miratoi projektligjin për skemat pensionale me 4 korrik 2023, përderisa në lexim të dytë Kuvendi e miratoi me 27 korrik 2023. Në të dy rastet, Qeveria dhe Kuvendi shkelën Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, sepse sipas kësaj gjykate kërkesa e saj është miratimi i ligjit që nënkupton hyrjen në fuqi dhe nisjes së zbatimit të këtij ligji nga data 15 korrik 2023, e jo miratimi në qeveri fillimisht me 19 ditë vonesë dhe nga ana e Kuvendit me 42 ditë. Kur kësaj i shtohet se për të hyrë ligji në fuqi, duhet të kalojë afati i kontestimit në Gjykatë Kushtetuese sipas Nenit 113, paragrafi 5 dhe afatit kur duhet të pritet që Presidentja ta nënshkruajë, atëherë kemi një situatë dhe praktikë të keqe të zbatimit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. Në vend se ligji të ishte në fuqi me 15 qershor 2023, të niste zbatimi i skemave të reja pensionale, rrjedhimisht do të pushonte diskriminimi, Qeveria dhe Kuvendi zbatuan me vonesë prej 62 ditësh zbatuan Aktgjykimin e GjK-së.

10.2 Shkeljet teknike gjatë zbatimit të Aktgjykimit për Ligjin për Zyrtarët Publik

Me 2 gusht 2023, Gjykata Kushtetuese, kërkesat për vlerësim të kushtetuetshmërisë të Ligjit për Zyrtarët Publik i deklaroi të pranueshme, konstatoi që disa nene të këtij ligji nuk janë në përputhje me Kushtetutën, e obligoi Presidenten që të shpall ligjin pa dispozitat e kontestuar. Gjykata, po ashtu e urdhëroi Kuvendin që në afat prej gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi, të ndërmerren veprime të nevojshme për plotësim-ndryshimin e këtij ligji të kontestuar, në pajtim me Kushtetutën.[48]

Në zbatim të Aktgjykimit, Ligji për Zyrtarët Publik u publikua në Gazetën Zyrtare me shtesat në paragrafin 2 dhe 5 të Nenit 9 të Ligjit edhe pse Gjykata Kushtetuese e rrëzoi një fjali të këtyre paragrafëve.

---

[47] *Programi Legjislativ për vitin 2023*, Qeveria e Kosovës, 2023. (https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/Programi-Legjislativ-per-vitin-2023-25.1.2023.pdf). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[48] *Aktgjykim në rastet KO216/22 dhe KO220/22*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 2 gusht 2023. (https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/09/ko_216_220_22_agj_shq_.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

Gjetjet e mos-zbatimit të drejtë të Aktgjykimit u vërejtën nga parashtruesi i kërkesës, të cilët me 21 shtator 2023 parashtruan kërkesën për korrigjim të Aktgjykimit në rastet K0216/22 dhe K0220/22. Gjykata vërejti se referenca në kriterin e "përshtatshmërisë" është eliminuar nga paragrafi 5 i Nenit 9-të, është eliminuar edhe nga fillimi i paragrafit 2 të po këtij neni, por jo edhe në fjalinë e dytë të paragrafit 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtaret Publikë.

Shtatë ditë më pas, Gjykata lëshoi urdhërin për korrigjim të një gabimi teknik në aktgjykim, pa formulimin e përshtatshmërisë në tërë paragrafin 2 dhe në paragrafin 5 të Nenit 9 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, aktgjykimi do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në gazetën zyrtare.[49]

11. Dëmi financiar i shkaktuar nga vendimet jokushtetuese

Gjykata Kushtetuese, në aktgjykimin në rastin 134/21 kishte rrëzuar vendimin e Kuvendit të Kosovës për shkarkimin e Bordit të Radio Televizionit të Kosovës, por sipas Gjykatës aktgjykimi nuk do të kishte efekt prapaveprues dhe nuk do t'i afektoj të drejtat e fituara të palëve të treta, në këtë rast për mandatet e anëtarëve të rinjë të Bordit të RTK-së. Sipas Gjykatës, ajo nuk ka tagrin të caktojë kompensim të dëmit për rastet kur konstatohet për shkelje të dispozitave kushtetuese. Por, kjo nuk e përjashton mundësinë ligjore që palët e afektuara nga një vendim i padrejtë, të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre bazuar në Kushtetute dhe ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

[49] *Urdhër Korrigjimi për rastin KO145/21,* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 2 gusht 2023. (https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/09/ko_216_220_22_agj_shq_.pdf). (Qasur për herë të fundit me 28 tetor 2023).

Raporti "Kushtetuetshmëria në qeverisje" është realizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi me mbështetjen e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan apo te National Endowment for Democracy (NED).

Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD